

UNITED NATIONS  
United Nations Interim  
Administration Mission  
in Kosovo



NATIONS UNIES  
Mission d'Administration  
Intérimaire des Nations Unies  
au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS  
СКУПШТИНА КОСОВА  
ASSEMBLY OF KOSOVO**

## TRANSKRIPT

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS,  
E MBAJTUR MË 02 TETOR 2003

PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA,  
ODRŽANE 02. OKTOBARA 2003.G.

Tetor - Oktobar  
2003



**KUVENDI I KOSOVËS  
СКУПШТИНА КОСОВА  
ASSEMBLY OF KOSOVO**

**RENDI I DITËS**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Menaxhimin e financave publike (2003/25),
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për pesticidet (2003/26).

**ДНЕВНИ РЕД**

1. Усвајање записника са претходне седнице,
2. Прво разматрање Нацрта закона о измени и допуни Закона о менаџирању јавним финансијама (2003/25),
3. Прво разматрање Нацрта закона о пестицидима (2003/26).

**AGENDA**

1. Approval of the minutes of previous meeting,
2. First reading of the Draft Law on changing and completing of the Law on Management of Public Finance (2003/25),
3. First reading of the Draft Law on aw on pesticide (2003/26).

# T R A N S K R I P T

## I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 02 TETOR 2003

Seanca Plenare u mbajt në sallën e Kuvendit të Prishtinës.

**SEANCËN E KRYESOI, AKADEMİK NEXHAT DACI,  
KRYETAR I KUVENDIT TË KOSOVËS.**

**BASHKËKRYYESUES, XHAVIT HALITI, ANËTAR I  
KRYESISË SË KUVENDIT TË KOSOVËS.**

Seanca filloi punën në orën 10,00.

**KRYETARI NEXHAT DACI:**

Mirëmëngjes kolegë deputetë,

Më lejoni që t'ju dëshiroj mirëseardhje juve dhe, në veçanti, kryeministrin dhe kabinetin të tij, në punën e Seancës së sotme të rregullt plenare.

Të gjitha materialet ju janë shpërndarë me kohë. Besoj se telefonat celular i keni ç'kyçur dhe kjo vlenë veçanërisht për Ivanoviqin se nuk i duhen kontaktet sot me Beogradin, por me Kosovën. Prandaj, jemi në një ditë të mirë, jemi të përgatitur dhe besoj se miratimi i Procesverbalit është punë rutinore dhe në qoftë se ndokush ka vërejtje, mund t'i bëjë me shkrim.

Unë do t'ju lutja për vëmendje dhe qetësi, si gjithmonë.

Para se të kalojmë në pikën e dytë, do të doja t'ju informoj për kontaktet shumintensive lidhur me këtë pikë të rendit të ditës. Përveç kësaj, do t'ju them se kanë arritur edhe dy shkresa: një shkresë nga zoti Sollana, që është emituar në media dhe është e nënshkruar dhe, do të thoja, është një letër e mirë, por është edhe një shrkesë për të cilën, unë ndiej obligim t'ju njoftoj, edhe pse nuk është thënë decidivisht... E kam një shkresë nga Grupi i Kontaktit, dje pasdite, në të cilën është përmbajtja e njëjtë: kërkohet sjellje e përgjegjshme e përfaqësuesve në institucionë. Përkujtohet se ne kemi marrë obligimet në Samitin e Selanikut në qershori dhe në një mënyrë shpjegoitet ajo që mediat e kanë patur. Edhe bisedat tjera telefonike janë të këtij niveli dhe të kësaj përmbajtjeje.

Prandaj, pa humbur kohë, që të kalojmë në pikën e dytë: Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë lidhur me marrjen e qëndrimit për bisedimet e mundshme Kosovë – unioni Serbi Mali i zi.

Ftoj kryeministrin e Kosovës ose personin, nëse e ka autorizuar ndokë tjetër për këtë që të marrë fjalën.

Zoti kryeministër foltorja është e juaja.

#### BAJRAM REXHEPI:

I nderuari kryetar i Parlamentit, të nderuar deputetë,

Dialogun me Serbinë, si një nga tetë standardet nga ish kryeadministratori Shtajner dhe të përkrahura nga institucionet relevante ndërkombëtare, Qeveria e Kosovës nuk e ka nënçmuar asnjëherë, por as nuk e ka përdimensionuar. Kjo çështje, disaherë, është trajtuar në Qeveri në mënyrë që, nëse vjen deri te dialogu, të jemi sa më të përgatitur.

Me të drejtë kemi kërkuar vazhdimisht që të transferohen sa më tepër kompetenca në Qeveri, që të shtohet funksionaliteti dhe efikasiteti karshi pritjeve reale të qytetarëve të Kosovës, përbushjes së standardeve, e në kuadër të tyre, edhe të dialogut, gjithashtu. Në këtë aspekt, deri më tanë, kemi hasë në mosgatishmërinë nga ana e UNMIK-ut.

Me ardhjen e kryeadministratorit Hari Hollkeri, në takimin e parë zyrtar, më 26 gusht 2003, në formë të shkruar, ia kam dorëzuar kërkesat minimale për themelimin e disa zyreve në Kryeministri, si hap i parë drejt ministrive të ardhshme. Por, përveç premtimit gojor – se do të shqyrtohen seriozisht; dhe pas më shum se dy muajsh, nuk kemi përgjigje decidive.

Në ndërkohe, Parlamenti i Serbisë dhe unionit Serbi Mali i zi ka aprovuar deklaratën kushtetuese, e cila Kosovën e pozicionon juridikisht si pjesë e Serbisë: Shkelje e Rezolutës 1244!? Reagimi i institucioneve relevante ndërkombëtare ka qenë, si zakonisht, i butë dhe në formën: se asnje akt unilateral i Serbisë ose i Kosovës nuk do të ketë ndikim në Rezolutën 1244!? Kjo paraqet një vështirësi gati të pakalueshme për suksesin e çfarëdo bisedimeve me Serbinë, qoftë edhe për çështje praktike.

Me të drejtë kemi pritur se kryeadministratori i ri do t'i ketë prioritete problemet aktuale të cilat e rëndojnë Kosovën, si: zhvillimin ekonomik dhe gjetjen e rrugëve për huazime nga institucionet financiare ndërkombëtare dhe perspektivën e hapjes së vendeve të punës; integrimin e komuniteteve minoritare; ngritjen e efikasitetit të shërbimit policor dhe të gjyqësisë; respektimin e rendit dhe ligjit; angazhimin e përbashkët për zgjidhje sa më të pranueshme për kategoritë sociale – arsimtarët, punëtorët shëndetësor, pensionistët, invalidët e tjera.

Si e papritur, tërë energjia e tij është koncentruar në dialog me Serbinë, duke siguruar mbështetjen e institucioneve relevante ndërkombëtare. Ndërsa, për institucionet vendore, është menduar se është e vetëm përfundim i kësaj etapës që do të marrin pjesë në dialog në çfarëdo forme, kohe dhe mënyre.

Në ndërkohe, Serbia cakton si palëbiseduese qendrën koordinuese, me në krye nënkyetarin e Serbisë, Nebojsha Çoviq aktiviteti destruktiv i të cilit është i njobur në dy-tri vitet e fundit, ndërsa delegacioni kosovar do të udhëhiqet nga kryeadministratori. Me këtë formë vetëmse legjitimohet marrëveshja Hakerup-Çoviq dhe bisedimet do t'i ngjanin bisedimeve në grupin e lartë të punës “Hajrenki-group”.

Kemi besuar edhe në premtimet e dhëna si më herët, e veçanërisht që nga dita e parë e ardhjes së kryeadministratorit të ri për eliminimin e institucioneve paralele serbe. Fatkeqësisht, deri më tanë, gjërat në terren as për njëgrimë nuk kanë lëvizur në drejtim të ushtrimit të pushtetit unik, qoftë në lëminë e arsimit,

shëndetësisë, adminisratës, transportit e komunikacionit, apo aspektet tjera të kompetencave të bartura në mbarë territorin e Kosovës.

Të gjitha këto, e shum të tjera, kanë qenë rrethana tejet rënduese që Qeveria të marrë vendim vetjak. Qeveria e koalicionit, e bazuar në Marrëveshjen e 28 shkurtit 2002, duke qenë e përgjegjshme ndaj qytetarëve të vetë, subjekteve politike dhe Parlamentit, ka diskutuar dhe vodosur për këtë:

Në vazhdim të mbledhjes së rregullt të 70-të të Qeverisë, të datës 27 shtator 2003, vendimi unanim i Qeverisë i është përcjellur Kuvendit të Kosovës, që për çështjen e dialogut të mirret vendim politik nga ana e Parlamentit, ku do të merrte pjesë edhe Qeveria, me të gjithë ministrat dhe të japim kontributin tonë, me sqarimet eventuale.

Pikat e vetme të propozuara, qysh nga zoti Shtajner, dhe të aprovuara në Samitin e Selanikut, për momentin janë: kthimi i të zhvendosurve; personat e zhdukur; energetika dhe transporti e telekomunikacioni. Dy nga këto pika janë plotësisht të rezervuara - kthimi dhe personat e zhdukur, ose të pagjetur. Ndërsa, energetika dhe transporti janë përgjegjësi të gërshetuara ndërmjet institucioneve vendore dhe atyre të UNMIK-ut.

Të nderuar deputetë,

Kryeministri dhe Qeveria në përgjithësi, nuk janë të gatshëm të marrin pjesë në bisedime me Beogradin pa një vendim pro të Parlamentit dhe, domosdoshmërisht, duke përfshirë konsensusin e tri grupeve parlamentare të subjekteve politike – nënshkruese të Marrëveshjes së 28 shkurtit 2002 për Qeverinë e Kosovës.

Ju falemnderit për vëmendje. Jemi të gatshëm, me të gjithë ministrat prezent, për debat dhe sqarim eventual.

#### KRYETARI NEXHAT DACI:

Kryeministër, ju falemnderit. Para se t'ua jap fjalën grupeve parlamentare, një lajm në ndërkohë për sqarim nga Nju Jorku.

Është vendosur që Hari Hollkeri, e udhëheqë vetëm delegacionin e UNMIK-ut, ndërsa delegacionin e institucioneve të Kosovës e udhëheqin institucionet në marrëveshje të vete. Ky ishte lajmi i fundit, prandaj ndjej si obligim... që nuk ka qenë deri në këtë moment.

Dëgjuam fjalën e Qeverisë, përmes kryeministrat tonë. Mendoj se grupet parlamentare do të kenë ndonjë fjalë lidhur me këtë. E ka fjalën profesor Sabri Hamiti.

### SABRI HAMITI:

Zotni, kryetar i Kuvendit, zotni kryeministër, ministra të Qeverisë së Kosovës, kolegë të çmuar e të nderuar,

Ne ndëgjuam artikulimin e kryeministrat të Kosovës lidhur me një çështje, për të cilën në kemi biseduar edhe dy javë më parë në këtë sallë. Ne nuk do të kishim kurgjë të shtonim të re nga ajo që kemi thënë para dy javësh. Aq më tepër, shum theksime nga fjala e kryeministrat duken sikur citat i asaj që është thënë para dy javësh këtu. Në këtë kuptim, ne shohim një tip të pëlqimeve të brendshme rrëth situatave politike në të cilat ndodhemi.

Nga ana tjetër, ne ndëgjuam këtu një prononcim të kryeministrat, jo s'hum të qartë çka kërcohët sot prej Parlamentit. Unë kérkesën, pos mëdyshjeve rrëth mundësisë së dialogut, kérkesën e qartë nuk e kuptova, totalisht. Në anën tjetër, thash – unë nuk kisha përsëritur asgjë nga ajo që është thënë në këtë foltore para dy javësh. Vetëm ndiej nevojë që të saktësoj ose të ripërkujtoj disa gjana, për hirë të nivelit të përgjegjësive të këtij institucioni, për hirë të zgjedhësve tanë, për hirë të opinionit.

Është mirë që të ritheksohen disa evidenca. Është mirë që të dihet botnisht që përfaqësues të institucioneve të Kosovës, që nga Samiti i BE-s në Selanik e tutje, në mënyrë së paku deklarative publike, kanë thënë se – janë zotuar për dialogje me fqinjt, natyrish përfshirë edhe Serbi dhe Mali i zi, që është fqinji ynë. Kjo është nën një.

Nën dy. Këta përfaqësues të institucioneve, por edhe të partive relevante politike të Kosovës, saherë kanë biseduar me eksponentë të politikës ndërkombëtare, së paku publikisht, unë qysh i kam pa, kanë thënë se janë për këtë dialog.

Kjo është evidente dhe këtë e dijnë gjithkush, qysh e dij edhe unë.

Unë kisha dëshirë që të sillemi në nivelin e përgjegjësive politike dhe udhëheqëse dhe definitivisht, sidomos njerëzit me përgjegjësi të naltë udhëheqëse të flakin; sa të jetë më e mundur, hipokrizinë politike dhe qëndrimet e formuara politike institucionale t'i mbrojnë njësoj – si në dyert e myllura, si në kontaktet symësy ose kokëmëkokë, si në kontaktet publike para zgjedhësve.

Unë k ujtoj që kjo është një domosdo e njerëzve përgjegjës në situatat ideale shoqërore, po aq më shum - në situatat që nuk janë ideale shoqërore.

Kuvendi ynë nuk ka arsy, arsy politike, të jetë kundër dialogjeve. Mirëpo, Kuvendi ynë është kaq i përgjegjshëm saqë: nëse dialogu është një standard i ashtuquajtur – i artikuluar nga Shtajneri, përkrahur nga institucionet tjera ndërkombëtare në Kosovë e jashtë saj, atëherë nëse standardi është një standard dialogu, atëherë edhe dialogu duhet të ketë standarde.

A i ka ky dialog standardet paraprake? Unë do të thosha: - jo. Një. Temat e propozuara, dy prej tyre, janë tema që unë, kujtoj, s'duhet të bisedohen hiq. Sepse, problemi i përgjegjësive për të zhdukurit në luftë, ai sankzionohet me konventa ndërkombëtare dhe ato janë të obligueshme: – shtetet që t'u përgjigjen. Dy, tema tjera të propozuara janë gjysmë-gjysmë. Dhe, këtu tash vjen problemi i përgjegjësive: UNMIK – Qeveri e Kosovës; që unë e kam thënë herën tjetër: është qeveri dykrenë, që është përgjegjësi të cilën nuk mund t'ia japim ne Qeverisë të plotë, por nuk mund t'ia japë as UNMIK-u. Domethënë është një problem i ndarë gjysmë-gjysmë. Kjo mund të ndodhë vetëm me marrëveshje të fortë në mes të Qeverisë sonë dhe të UNMIK-ut para se të fillojë një dialog i mundshëm për probleme konkrete.

Dhe, në fund: Nëse nevojitet një dialog për një fotografi të përbashkët, si dëshmi se njerëzit mund të shihen në një tavolinë edhe të fotografohen, unë e konsidreroj të padobishëm. Sepse, është lojë! Nëse është nevoja imanente e shoqërisë së Kosovës që të bisedohet për probleme të qytetarëve, - po. Mirëpo, nuk ka kurrfarë interes i konkret qytetar në Kosovë sot që mund të plotësohet në rast se prishet perspektiva politike e atij qytetari. Ju falemnderit.

## KRYETARI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Profesor Arsim Bajrami, Partia Demokratike.

## ARSIM BAJRAMI:

I nderuari kryetar i Parlamentit, zoti kryeministër, të nderuar ministra, të nderuar kolegë,

Përshëndes ardhjen e kryeministrat e të Qeverisë sipas ftesës së Parlamentit dhe sipas iniciativës së vetë Qeverisë dhe mendoj se me këtë po përbushet edhe një detyrim kushtetues i Qeverisë që të vjen para Parlamentit me rastin e marrjes së vendimeve të rëndësishme politike.

Tema, të cilën sot po e diskutojmë, është temë që është filluar qe dy javë dhe Parlamenti ka filluar debatin dhe në një mënyrë i ka shprehur opinionet e para, edhe pse, në emër të Partisë Demokratike të Kosovës, mendoj se ai debat nuk ka qenë i mjaftueshëm dhe nuk ka qenë i përmbyllur, siç është kérkuar.

Unë mendoj se tema që sot po e diskutojmë, është ndër temat më të rëndësishme politike dhe kérkohet prej nesh një përgjegjësi e lartë, një përgjegjësi e lartë që do të shprehë edhe autoritetin që kemi.

Siç dihet Kosova, edhe në prononcimet përmes institucioneve, gjithmonë ka përkrahë një politikë të bashkëpunimit, një politikë të fqinjësisë së mirë me të gjitha shtetet e rajonit, duke përfshirë këtu edhe Serbinë.

Mirëpo, siç dihet, Kosova po ecë shumngadalë në implementimin e Rezolutës 1244 dhe, do të thoja, në përgatitjen e saj për zgjidhjen finale të statusit të Kosovës, që është edhe një nga obligimet parësore të UNMIK-ut dhe të Kombeve të Bashkuara, pra për të lehtësuar një zgjidhje politike, për një zgjidhje finale të statusit të Kosovës.

Dhe, në kushtet kur Kosova, shumngadalë po mëveshet me kompetenca dhe shumngadalë po merr përgjegjësi për të dëshmuar aftësitë e veta qeverisëse, nga Kosova kérkohet të hyjë në një proces me Serbinë, në kondita krejt të pafavorshme dhe të pabarabarta për dy arsyen: E para, për shkak se Serbia ka koncipuar një politikë shtetërore agresive ndaj Kosovës, duke kryer, duke tentuar bërjen e agresionit kushtetues përmes akteve kushtetuese. Dhe, e dyta,

për shkak se Kosova shkon me një pozicion shum të pabarabartë, pra me pakompetenca dhe me një përfaqësim që, do të thoja, nuk është krejt i barabart.

Në anën tjetër, bashkësia ndërkombëtare, e cila ka vë një nga standardet – bisedat me Beogradin, mendoj se shumngadalë - shumngadalë ka përgatitur Kosovën që të formojë një identitet politik dhe juridik; shumngadalë po e implementon Rezolutën 1244 dhe, tani po hyjmë në vitin e pestë të implementimit të kësaj Rezolute, – Kosova është ajo që ishte në kohën e miratimit të kësaj Rezolute, me pakompetenca, do të thoja, pa mundësi të shprehjes së identitetit të vet.

Në anën tjetër, bashkësia ndërkombëtare, përpos deklarimeve verbale, që i dëgjuam edhe dje nga zoti Sollana, nuk ka marrë veprime konkrete institucionale, do të thoja, edhe veprime ligjore, që në një mënyrë ta parandalojë Serbinë në këto tentativa të agresionit kushtetues dhe nuk ka marrë një veprim shprehimor çfarë ka qenë e mundshme për t'i shpallur të pavlefshme ndaj Kosovës dhe për të mundësuar që në një fazë të mëvonshme të mundësohet një zgjidhje demokratike e statusit të Kosovës.

Në këtë kontekst, mendoj se duhet të shiqojmë realisht – a është Kosova apo s'është e përgatitur për këto biseda.

Mendoj se ky Kuvend ka nevojë që edhe sot, por edhe në formë zyrtare dhe ligjore, të bëjë me dije edhe bashkësinë ndërkombëtare - edhe Serbinë edhe palët tjera, që statusi final i Kosovës, do të thoja, implementimi i një vullneti politik plebishitar të popullit të Kosovës – është një çështje që do të vendoset ekskluzivisht nga populli i Kosovës, nga ky Parlament demokratik dhe në një bashkëpunim me faktorin ndërkombëtar. Dhe këtë duhet ta bëjmë me dije dhe mendoj se jo vetëm ta bëjmë me dije por edhe të fillojmë të përgatitemi për shkak se ky Parlament edhe ka mandatin për ta realizuar atë qëllim.

Në këtë kontekst, unë mendoj se shqetësimet që i shfaqi kryeministri, janë edhe shqetësime reale të këtij Parlamenti dhe janë shqetësime që duhet të mirren parasysh para marrjes së një qëndrimi politik.

Mendoj se kushtet për një proces të dialogut me Serbinë nuk janë plotësuar, për faktin se çështjet që propozohen dhe që paralajmërohen janë çështje të karakterit politik dhe çështje që nuk janë bartë te institucionet e Kosovës dhe një logjikë normale, një logjikë normale – do të kërkonte që paraprakisht UNMIK-u të fillonte procesin e bartjes së përgjegjësive nga kreu i pestë i

Kornizës kushtetuese, por do të thoja edhe të gjitha përgjegjësive tjera, në mënyrë që të realizojë obligimin ligjor që ka edhe me Rezolutën 1244 edhe me Kornizën kushtetuese, pra lehtësimin e një zgjidhjeje finale të statusit final të Kosovës.

Kështu, në emër të Partisë Demokratike të Kosovës, kërkoj që paraprakisht UNMIK-u, përmes zotit Hollkeri dhe me autoritetin e tij, të marrë vendimin për fillimin e menjëhershëm të bartjes së përgjegjësive dhe kompletimin e strukturës qeveritare dhe strukturës tjetër institucionale të Kosovës në mënyrë që Kosova të jetë plotësisht e barabartë.

Parakushti i dytë: kërkojmë që Kuvendi i Kosovës, edhe pse i vonuar në këtë çështje, i vonuar padrejtësisht, megjithatë të shprehë jovalide, inekzistente apo nul të gjitha këto veprime të njëanëshme të Serbisë me të cilat po kryhen agresione kushtetuese dhe të mospranojë asnjë pasojë juridike dhe politike në raport me Kosovën, e dhe p se, p o p ërsëris, një obligim i tillë ka qenë edhe i UNMIK-ut dhe i autoriteteve ndërkombëtare, të cilat, siç dihet e kanë pru Rezolutën 1244.

Çështja e tretë, që mendoj, është shum e rëndësishme – është çështja e palëve në këto negociata. Dëgjova sot kryetarin për një lëvizje të rolit të zotit Hollkeri dhe mendoj se këto kontakte, ashtu siç po paralajmërohen, nuk premtojnë një efektivitet, duke qenë se nuk premtohet një ndërmjetësim adekuat ndërkombëtar i subjekteve me relevancë politike. Dhe e dyta, roli i UNMIK-ut, është disi i pakjartë – nuk dihet se a do të udhëheqë delegacionin kosovar, a do ta udhëheqë UNMIK-un dhe cili është roli i UNMIK-ut. Mendoj se UNMIK-u duhet të mbrojë vetëm interesat e Kosovës. Nuk mund të ketë neutralitet apo rol ndërmjetësues, për shkak se Përfaqësuesi Special, zoti Hollkeri, është Përfaqësues Special i Kombeve të Bashkuara për Kosovën dhe për ta mbrojtur Kosovën dhe të drejtat e qytetarëve, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre nationale. Kështu, në këto kushte, kur ai nuk ka precizuar rolin e tij, është shumskeptike se a mund të kemi një ndërmjetësim adekuat dhe efektiv.

Dhe, çështja e fundit, që mendoj se është me rëndësi të diskutohet: sa janë bërë përgatitjet efektive të Qeverisë së Kosovës dhe do të thoja të Parlamentit të Kosovës që vërtetë Kosova të jetë e përgatitur për këto kontakte? Mendoj se nuk janë bërë dhe mungon një platformë e kjartë, e plotë, me strategji, me nënstrategji, me një përfshirje të ekspertëve e cila do të siguronte që Kosova të ketë një përfaqësim të denjë në këto kushte.

Dhe, mendoj se Qeveria e Kosovës, nuk guxon të shkojë formalisht në këto... për të përbushur një standard ndërkombëtar apo për të bërë një fotografi të mirë, por nëse Parlamenti do të vendosë një gjë të tillë, duhet të shkojë krejt e përgatitur dhe me synime shum të kjarta.

Dhe, së fundi, meqenëse kjo çështje është shum e rëndësishme, unë kërkoj dhe kam kërkuar dy herë, po e përsëris edhe herën e tretë: – kërkoj që rrëth kësaj çështjeje të thirret edhe zoti Hollkeri, meqenëse ai po paralajmëron se do të jetë aktiv, por edhe kryetari i Kosovës. Ai ka edhe një detyrim kushtetues që t'i drejtohet këtij Parlamenti në mënyrë që vërtetë të arrijmë konsensusin institucional, çfarë e kërkoi edhe kryeministri, por edhe konsensusin politik.

Dhe së fundi, mendoj se jemi para një përgjegjësie, për shkak se prej neve kërkohet një politikë realiste, një politikë e mençur por mendoj se në asnje rrëthanë ne nuk duhet të bijmë pre e presisoneve por duhet të kemi parasysh interesat e Kosovës, interesat e qytetarëve të Kosovës dhe misionin që ka ky Parlament. Ju falemnderit.

#### KRYETARI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Dragisha Kërstoviq, shef i Grupit parlamentar “Kthimi”.

#### DRAGIŠA KRSTOVIĆ:

Gospodine predsedniče Skupštine, gospodine predsedniče Vlade, gospodo ministri, dame i gospodo poslanici,

Stanje na Kosovu i Metohiji nije dobro, niti i ma izgleda da se pod ovakvim stanjem stvari uskoro popravi. Bezbednost i sloboda kretanja za Srbe, u mnogim delovima Kosova i Metohije, u opšte ne postoje. Povratak raseljenih je gotovo beznačajan. Sudbine otetih i kidnapovanih nisu rasvetljene; privremene institucije Kosova i Metohije nisu učinile gotovo ništa da se ovi problemi razreše. Prošlo je mnogo vremena a da po ovim pitanjima ništa nije učinjeno. Mi mislimo da ova kao i mnoga druga životna pitanja moraju da se reše i to u skladu sa standardima i dostignućima u civilizovanim delovima sveta. Veoma je dobro što je to shvatila i medjunarodna zajednica i što je preko Kontakt grupe, Saveta bezbednosti Ujedinjenih nacija, Evropske Unije i Saveta Evrope, čvrsto

rešeno da istraje na rešavanju svih problema koji otežavaju život običnim ljudima na ovom prostoru.

Poslanici Koalicije «Povratak» podržavaju sve napore koje medjunarodna zajednica čini da se na Kosovu i metohiji normalizuje stanje i da se stvore uslovi za miran i bezbedan život svih ljudi koji ovde žive, i koji su ovde živeli, i koji žele da se ovde vrate. Druge alternative, ovakvim naporima nema, niti ima druge alternative mernom i bezbednom životu svih građana Kosova i njihovoj slobodi kretanja i poštovanju svih njihovih ljudskih i drugih prava.

Ono što smo do sada uz pomoć medjunarodne misije učinili da ove probleme rešimo i da stanje na Kosovu dovedemo u red nije bilo dalo rezultate kojima bi smo bili zadovoljni. Zbog toga mislimo da su razgovori državne zajednice Srbije i Crne gore i privremenih institucija samouprave Kosova realna šansa da se ovi problemi reše i da Kosovo i metohija krenu u bolju budućnost i da se stvore uslovi za miran i bezbedan život za sve ljude, da prošlost ostavimo što dalje iza nas i da se u svemu pridržimo... pridružimo civilizovanim narodima i drutšvima Evrope i sveta. Što pre to budemo shvatili, to ćemo i pre prošlost a i sadašnjost ostaviti iza i krenuti u bolju i sigurniju budućnost. S toga mislimo da ni razgovori o svemu ovome takodje nemaju alternativu i da su oni prilika da preko njih zakoračimo u budućnost ovog prostora.

Ako ovu šansu budemo propustili, ako naš pristup razgovorima državne zajednice Srbije i Crne gore i privremenih institucija samouprave Kosova bude nešto drugo, a te razgovore budemo okrenuli u pogrešnom pravcu, što neodgovorni političari mogu da učine, onda će nam teška sadašnjost biti mnogo duga a budućnost će nam stalno izmicati.

Poslanička grupa Koalicije «Povratak» pozdravlja napore medjunarodne zajednice da razgovori otpočnu i smatra da je ovo prilika da napravimo veliki zaokret u odnosu na stanje koje imamo i da pravi i iskreni razgovori mogu dovesti do približavanja i pomirenja svih zajednica na Kosovu, a pre svih Albanske i Srpske zajednice.

Zato vas pozivam da pokušamo da razgovaramo, da izgradujemo ono što mnogi narodi već odavno imaju i da budemo hodočasnici novog doba za Kosovo. Ovo nam je najbolja prilika.

Na kraju moram da kažem da ne razumem neke stavove koje su ovde izrećene već. Naša zabrinutost se nažalost zbog toga povećava ali mi smatramo današnje nade za rešavanje problema Kosova ipak ima. Hvala vam.

### KRYETARI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Zoti Ramush Haradinaj, në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

### RAMUSH HARADINAJ:

I nderuar zoti kryetar, kryeministër, ministra, të nderuar kolegë deputetë,

Në këtë rast, përpos atyre që kemi bërë me dije edhe më herët që kemi thënë, unë do të ndalem në atë dhe dëshiroj ta theksoj, që të sqaroj edhe parafolës në këtë foltore: –pse ne mendojmë se përgatitjet për këto bisedime janë improviziv. Pra, është një dallim i madh nga një qëndrim parimor se a jemi ne për biseda me fqinjt dhe pse kemi një qëndrim ndrysht për këtë që po përgatitet. Natyrshëm, se jemi të interesuar që të kemi biseda me fqinjt dhe do t'i mbështesim këto biseda, por edhe kur ne i jemi fqinj dikuj, ndërsa kur nuk trajtohem si të këtillë, e kemi t'vështirë të zhvillojmë marrëdhënie ndërfqinjësore.

Përgatitjet për këto biseda teknike janë improvizim për shum shkaqe, për shum arsyen. Në radhë të parë, askush nga ne nuk ka një plan me detaje, me gjithçka, një skemë se si kishim pasë me fillue. T'ua jap vetëm një shembull – pse janë improvizim? Zoti Hollkeri vjen me delegacionin e Kosovës, qoftë si kryesues i delegacionit, qoftë si ndërmjetësues: “U mbajt takimi i parë, simbolik, u shtrënguan duart, përfundoi”! Kush është adresa jonë pastaj? Kujt i drejtohemi ne për me dijt, me pyet, me shprehë, me sqarue rreth bisedave?

Ne jemi deklaruar edhe në këtë foltore: kërkojmë një ndërmjetësues serioz, relevant ndërkombëtar; një adresë që, pastaj edhe pas takimit të parë simbolik, të dijmë kush është adresa jonë dhe kemi thënë se duhet të jenë përfaqësuesit e Qeverisë Amerikane, qofshin këto simbolike, qofshin çfarëdo - është në nderin tonë dhe në moralin tonë t'i ftojmë këta njerëz edhe për të qenë prezent; vetëm për të vëzhgjuar, t'iu bëjmë një nderë kur dijmë se bashkësia ndërkombëtare ishte e udhëhequr nga këta në momentet kur u vë në mbrojtje dhe në ndërprerje

të konflktit në Kosovë. Të merren njerëzit e Kosovës, liderët e institucioneve në këtë rast, në një takim të këtillë, pa iu thënë sakt detajet e kësaj – nuk është në rregull. Nuk është në rregull të vjen një kërkesë në Parlament për biseda pa një skemë, pa u d ijt sakt kush-e-kush në çdo aspekt. Dhe si mund n e t 'i dhëmë mbështetje bisedave të këtilla kur kemi kaq paqartësi: është caktuar data, janë caktuar shum çështje tjera, aspekte tjera, agjenda dhe nuk ka...

Edhe një aspekt tjetër, që i bën improvizim këto biseda. Improvizim në kuptimin e plotë të fjalës: Zoti Hollkeri thotë se ka ndërtuar “task fors”, pra ka ndërtuar një ekipë, një grup pune për me pasë sukses bisedat. Kush i zhvillon këto biseda, atëherë? A i zhvillon UNMIK-u, qeveria e UNMIK-ut apo Qeveria e Kosovës? Në rast se është Qeveria e Kosovës, në rast se kryetari i Kosovës duhet të marrë pjesë, kryeministri dhe t'ia s htrëngojë dorën p alës tjetër, këta duhet t'i kenë “task forsat” dhe nuk është mandati i zotit Hollkeri t'i përforcojë, t'i rrisë kapacitetet e bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë por është që t'i zvogëlojë ato dhe të gjitha këto përgjegjësi t'i kalojë tek institucionet vendore. Pra, mandati i tij është me ndërtue kapacitetin e institucioneve të Kosovës. Ne ia kemi shprehë këtë kërkesë nga dita e parë. Edhe pse e kemi kuptuar se ai i ka nxjerrë në prioritet bisedat teknike me Beogradin, nuk kemi dashtë që t'i pengojmë dhe t'i bllokojmë këto biseda, gjithnjë me shpresën se Hollkeri e kuption se ne gjykojmë atë vetëm sa ai bën me rritë kapacitetin e institucionve të Kosovës, të Qeverisë së Kosovës, sa i bën me i dhënë mundësi institucioneve të Kosovës me u aftësuar për biseda të mundshme.

Meqenëse ai nuk ka shprehë a snjëfije rrespekti deri më sot, asnjë përfillje të njerëzve tanë të institucioneve, ne nuk mund të jemi të këtillë që t'i japim një “po” bisedave të kësaj forme. Është një improvizim i plotë që ka ndodhë!

Ta marrim një shembull tjetër: pse pengohet në Kosovë të ketë ministri të rendit, ministri të drejtësisë - kur dijmë se edhe krahinat nëpër shtete qofshin federale, qofshin tjera, kanë ministri të rendit. Meqenëse këto biseda janë teknike, çfarë po thuhet se janë, atëherë të aftësohet Kosova, të paktën, në ato lëmi që ende nuk i jepin atributin e shtetit. E kuptojmë se ka më shum vështirësi për ministrinë e mbrojtjes, për ministrinë e jashtme. Por, që të mos lëvizet, në këto aspekte, nuk ka më kuptim!

Unë mendoj se Parlamenti i Kosovës nuk duhet t'i japë “po”-në Qeverisë përderisa Qeveria nuk sjell në këtë Parlament kërkesën për aprovim të Qeverisë së kompletuar. Kërkush nuk do t'na i japë neve as qeveritë, as ministritë, as diçka, në rast se ne vetë nuk i kërkojmë, nuk i votojmë dhe nuk ua dërgojmë

ofertën se çka synojmë ne. Kryeministri i Kosovës duhet të vjen në këtë Parlament me propozimin, me Qeverinë e kompletuar me të gjitha ministritë; me programin për qeverinë për ministritë shtesë të kërkojë votimin. Natyrshëm, Hollkeri duhet të jetë personi i mramë që do ta marrë ofertën tonë, një ofertë që ka kaluar në këtë mënyrë, nëpër këtë zinxhir të vendimmarrjes. Dhe me këtë ofertë të plotë, ne pastaj, në bazë të mirëkuptimit ose të rrespektit ndaj ofertës që ne i kemi bërë përfaqësuesit të bashkësisë ndërkombëtare, shprehim gatishmërinë për partneritet. Në rrëthana tjera, ne jemi duke humbë kohë dhe mendoj se është momenti vendimtar që të qartësojmë pak si duhet të funksionojmë.

Pra, i takon Qeverisë së Kosovës që të ulet, së bashku, që të bisedojë, që të kompletojë një projekt për një qeveri, me të gjitha ministritë; të bisedojë dhe të votojë në Qeveri projektin, planprogramin e Qeverisë me ministritë shtesë, me të gjitha ministritë shtesë; ta sjellë këtë projekt të Qeverisë në Parlament që ta votojmë, pastaj t'lutna që t'ju votojmë edhe për me shkue në biseda. Por, pa i bërë këta hapa konkret ne nuk e kuptojmë se jemi serioz dhe nuk mund të veprojmë në këtë mënyrë.

Njëjt i takon edhe institucioneve të Kosovës, Parlamentit të Kosovës, t'i japë përgjigje asaj që ka bërë parlamenti i Serbisë. Parlamenti i Serbisë na ka shti në kushtetutën e vet. Ne nuk kemi dhënë përgjigje. Ne jemi për biseda me fqinjt, por ne nuk jemi fqinj atëherë. Ne jemi pjesë e një territori tjetër në këtë situatë qysh po sillemi. Le t'i kryejmë obligimet tona. Ta shpallim pavarësinë në këtë Parlament sot: -nesër e përcjellim në aeroport delegacionin tonë për me shkue në biseda. Ose, le ta votojmë Qeverinë e kompletuar, edhe pa na dhënë Hollkeri, nesër do të shkojmë bashkë deri në aeroport me i përcjellë. Por, jo në këtë formë.

Pra, ju lus deputetë mos t'bëhi pjesë e veprimeve të dëmshme për ne dhe për këtë popull.

Populli i Kosovës meriton që me pasë një qasje korrekte nga ne ndaj vetëvetes por edhe nga bashkësia ndërkombëtare. Ne nuk duhet të jemi objekt që me ne të sillen në këtë mënyrë. sikurse po ndodhë deri më tanë. Ju falemnderit.

**KRYETARI NEXHAT DACI:**

Ju falemnderit. Zoti Sadik idrizi, në emër të grupeve tjera etnike në Parlament.

**SADIK IDRIZI:**

Poštovani predsedavajući, gospodo ministri i kolege poslanici,

Ostale zajednice će podržati stav većine u Parlamentu Kosova u vezi eventualnog dijaloga između Prištine i Beograda. Ostale zajednice žele da budu uključene ukoliko dodje do dijaloga, jer imaju i specifične probleme. U prošlosti smo bili svedoci da su iz redova ostalih zajednica bukvalno sa ulice odvodjeni ljudi na razgovore koji nisu predstavljali ove zajednice pa su kasnije kompletne zajednice imale problema sa tim. To je bilo posebno prije rata na Kosovu, kada su, nekompetentni ljudi koji nisu imali ni glas naroda, pozivani da predstavljaju taj narod. Ovoga puta ne želimo da se to dogodi, nego želimo da, ukoliko budemo uključeni, budu predstavnici koji su dobili glas naroda i da o tim predstavnicima odlučuje Parlamentarna grupa ostalih zajednica.

Znači, podržaćemo stav većine jer svesni smo koja je naša pozicija u ovim razgovorima eventualnim i ukoliko se, znači, u ovom trenutku albanska većina ne nadje znači koncenzus odnosno ne nadje..., ne napravi većinu za razgovore – bilo bi neprihvatljivo da mi nešto unapred kažemo. Znači bićemo uz većinu u Parlamentu. Hvala.

**KRYETARI NEXHAT DACI:**

Ju falemnderit. Një sqarim, para se t'ua jap fjalën.

Sot nuk është debat për ndonjë temë të caktuar. Unë e kam lexuar me qëllim rendin e ditës. Prandaj, çdonjëri me vëmendje i dëgjuam të gjitha grupet parlamentare aq sa kishin në plan të flasin. Ata të tjerët, që marrin fjalën, dhe mendoj se do të jetë numër shum i vogël, duhet të përqëndrohen në këtë. Xhavit Haliti, si anëtar i Kryesisë, sepse me rregullore... Urdhëro Xhavit.

## XHAVIT HALITI:

I nderuar kryetar, i nderuar kryeministër, ministra, të nderuar kolegë e kolege,

Mendoj se në përgjithësi politika e Kosovës, politikajt, grupet parlamentare, subjektet në përgjithësi pa dallim, edhe përfaqësimi nacional, janë deklaruar që nuk janë kundër dialogut me shtetet fqinj. Po para se të themi – me shtetet fqinje, do të duhej ta pyesnim vetëveten se çka jemi ne dhe çfarë përfaqësojmë ne në këto bisedime.

Prandaj, në këtë drejtim do të shtroja disa çështje të cilat janë ngritur gjatë këtyre ditëve gjatë debateve të organizuara në Serbi dhe që te ne nuk kanë qenë prezente, si dhe mendimin tim se a duhet apo s'duhet me bisedu në këto rrethana.

Deri më tani, të gjithë përfaqësuesit zyrtar të Serbisë janë deklaruar që “ne do bisedojmë me pjesën tonë”, me “krahinën tonë” dhe në asnje mënyrë nuk do të bisedojmë me një vend fqinj qysh po kemi qef ne dhe q ysh po deklarohemi nganjëherë akoma pa e definue çështjen tonë.

U thanë shum çështje dhe shum gjana të cilat nuk e kontestuan mundësinë e dialogut dhe të shkuarjes për bisedime, sepse ne, po e them – si pale si shqiptarë, kemi përvojë edhe në të kaluarën që nuk kemi pritu me shkue edhe në Serbi dhe me u takue edhe me udhëheqjen e Serbisë për t'u marrë vesh. Megjithatë, a snjëherë, a snjë marrëveshje të bërë qoftë nga institucionet e së-kaluarës “krahinë autonome”, qoftë më vonë takimet dhe kontaktet që janë bërë dhe marrëveshjet e nënshkrueme në Beograd – asnëherë s'kanë qenë të suksesshme.

Çështja e kërkesës së Qeverisë, unë mendoj se nuk është e plotë, për faktin se kur thuhet – do flasim për çështje të cilat janë ngritë: telekom, transporti, njëra e tjetra. Mendoj se s'pari të zhdukurit dhe kthimi, unë mendoj nuk janë çështje për negociata. Nuk janë absolutisht çështje për negociata sepse edhe pala serbe, edhe pala shqiptare është e interesueme që këtë çështje ta zgjidhë. Janë deklaruar të gjithë. Mendoj se institucionet ndërkombëtare janë duke punu që të zbardhin të gjitha problemet, të gjitha çështjet e të zhdukurve dhe të kidnapuarve, që po thojnë, qoftë nga ana e Serbisë që numri është shum – shum më i madh sesa ata që pretendojnë që mund të jetë dikush i kidnapuem në Kosovë dhe, bile-bile i fshehur.

Tani do të shtroja një çshtje: Mendoj se ne në Kosovë kemi nevojë për një dialog të brendshëm dhe së pari duhet të fillojë dialogu në mes shqiptarëve, në mes të subjektit politik shqiptar sepse pa marrë parasysh që po deklarohemi nëpër foltore dhe për media, unë jam i bindur që subjekti politik shqiptar nuk është i marrun vesh mesveti.

Së dyti, mendoj që shqiptarët e Kosovës domosdoshmërisht duhet të fillojnë dialogun me koalicionin “Povratak”, me serbët e Kosovës dhe t'i trajtojmë problemet, që ky koalicion që participon në Kuvendin e Kosovës: – a është duke punuar në Kosovë për interesat e Kosovës apo për një shtet fqinj për të cilin po deklarohemi shumherë.

Së terti, mendoj që Kosova ka nevojë të fillojë dialogun me UNMIK-un dhe të merremi vesh për kompetencat, për të gjitha ato të cilat realisht shumherë po na dalin të paqarta dhe edhe në Kornizën kushtetuese një pjesë na jepin kompetencat, në pjesën tjeter na i marrin dhe as ne nuk e kemi të qartë çfarë kompetencash kemi. Po themi që Qeveria nuk guxon me nënshkru diçka gjatë bisedimeve që mund të bëhen nesër me Serbinë ose Serbinë e Malin e zi, as unë nuk e kam të qartë - po në mes Kosovës “pokrajinë e Serbisë” apo në mes kujt është kjo p unë, por me dokumentat që ka Kosova, me Kornizën kushtetuese Kosova nuk ka... Parlamenti i Kosovës nuk ka kompetenca me ratifikue asnje marrëveshje. Prandaj, këto çështje unë mendoj duhet patjetër me i zgjidhë.

Së dyti, në qoftë se është çështja e bisedimeve për t'u zgjidhur, pra problemet e serbëve në Kosovë, për t'u zgjidhur çështja e sigurisë së tyre dhe kthimit, u thanë kompetencat dhe mos t'i përsëriti. Megjithatë, mendoj se, në qoftë se për çështjen e serbëve në Kosovë duhet me qenë prezent Beograd, atëherë do të duhej me qenë prezente edhe shtetet tjera fqinje, të cilat janë të interesueme edhe për shqiptarët, edhe për turqit, edhe për muslimanët në Kosovë.

Dhe përfund, mendoj që ne i kemi djegë “aniet” për të udhëtuar për Beograd. Kushdo që të mendojë ndryshe, e ka gabim. Kushdo që përpinqet me ndërtue ndonjë trap për me u rikthye atje, e ka gabim. Se, ai trap do të fundoset.

Prandaj, mendoj që bashkësia ndërkombëtare dhe Serbia, dhe ne këtu si deputetë, do të duhej të kërkonim që me Serbinë të nënshkruajmë si Kosovë një marrëveshje paqe në mes dy vendeve tona, duke kerkuar fillimi që Serbia t'i tërhjekë forcat e saj të armatosura në kufi me Kosovën, që nuk e dijmë pse po i mbanë, sepse agresion nga Kosova nuk ka. Marrëveshja e paqës në mes

Kosovës dhe Serbisë, formale le të jetë ajo, do të ndikojë në vazhdimin e bisedimeve për interesa të përbashkëta të të dy vendeve. Ju falemnderit.

### KRYETARI NEXHAT DACI:

Unë do t'ju lutja për pak qëndrim dhe vëmendje. Në seancë janë të pranishëm 105 deputetë. Do të thotë është numër irespektabil që nuk e kemi pasë kohë të gjatë dhe kjo tregon seriozitetin e çështjes që është diskutuar.

Unë dua t'i ndaj me ju disa përshtypje dhe të marrim një qëndrim.

Në bisedë me zotin Hollkeri i kam shtruar një dilemë dje, sepse kontaktet e mia me grupet parlamentare, me Kryesinë në ndërtësë dhe jashtëndërtese, kanë qenë vërtetë intensive dhe kam shpreh dilemën - a e vlenë që një unitet funksional i arritur me shum mund për një vit e gjysmë në Parlament dhe në Qeveri, që me një shpejtësi të madhe të konsumohet pa i analizuar mirë rrjedhat e nesërme dhe në këtë e kam: nën një - funksionimin e Qeverisë, të cilët ndoshta shpeshherë pavend ky Parlament i ka dhënë besim enorm të madh për me një dëshirë pozitive që të kemi rezultatle. Këtë hamendje timen e ka shtuar edhe më tepër shkresa e Grupit të Kontaktit dje. I kam theksuar sjelljet në bashkësinë ndërkombëtare dhe këtë kryetarit të Parlamentit të Evropës në takimin tim, që nuk kam dasht mediave..., por sot po e bëj publike. I kam thënë: "Si mund ta ruajmë unitetin funksional, në qoftë se institucioni më përgjegjës i Evropës ose ndër më përgjegjësit – Asamblea Parlamentare e Këshillit të Evropës i lejon përfaqësuesit të Serbisë që të thotë të gjitha të zezat për Kosovën, për institucionet e saj dhe për bashkësinë ndërkombëtare në Kosovë, ndërsa ne nuk e kemi atë të drejtë as fizike që t'i ofrojmë bashkësisë ndërkombëtare argumente të kundërtat." Do të thotë një qasje plotësisht – plotësisht diskriminuese!

Unë nuk kam kërkuar praninë tonë si anëtar i plotë, por i kam thënë: "Shkelqësia juaj, - si është e mundur për një vit e gjysmë institucionet tona qeverisëse të mos jenë në asnjë mënyrë, në asnjë nivel, të pranishme në institucionet e bashkësisë ndërkombtare! Çfarë porosie është për mua kjo – çka t'ju them të enjen në Parlament deputetëve?"

Të njëjtën gjë e kam thënë edhe për seancën e Këshillit të Sigurimit, ku akuzohet Kosova dhe kosovarët për një çështje që ne të gjithë e kemi dënuar, sepse janë vra fëmijët kosovar. Po sa vrasje n'ditë ngjanë në botë dhe nuk tubohet Këshilli i Sigurimit?

Ne e dënojmë krimin, sepse vritet ardhmëria jonë. Po çfarë do të thotë ajo, çfarë porosie është për Kosovën dhe kosovarët në qoftë se ne, edhe pas luftës çlirimtare, edhe pas pranisë së bashkësisë ndërkombëtare këtu nuk mund ta themi fjalën tonë në organet e vendosjes. Dhe ky është mendimi i të gjithë deputetëve. Ky është mendim i krejt popullit të Kosovës,

Është shum e vërtetë ajo që ne kemi treguar gatishmëri më të madhe se kapacitetet vepruese tonat dhe e kemi dërguar në përbërjen më të fuqishme institucionale Delegacionin tonë në Selanik - pas punës njëvjeçare që kemi bërë me bashkësinë ndërkombëtare, dhe çfarë pësuam ose çfarë përjetuam në atë takim?! Me një kërkesë ad hok të fqiut, fshihet krejt mundi dhe djersa e institucioneve kosovare. Është një porosi e keqe për institucionet e Kosovës – porosi e keqe!?

Dhe, unë do ta porositja, në veçanti Evropën dhe institucionet e saja: të mos më bëjnë mua, ose dikujt tjetër – kryeminsitrit, ftesa individuale për asgjë. Ata që kanë qenë në takim me mua me kryetarin e Parlamentit të Evropës janë dëshmitarë. Kryetarit të Parlamentit nuk i duhen vizita private. I duhet prania e Parlamentit të Kosovës në mënyrë që nga dora e parë e institucioneve parlamentare të Evropës t'i japë rrjedhat në Kosovë dhe në mënyrë reverse ta kthejë atë njojuri që e ka marrë atje në Parlamentin e Kosovës.

Alternativë tjetër ne nuk do të pranojmë, nuk do t'akceptojmë. Jemi shum të përgjegjshëm, të gjithë. Të gjithë, prej prezidentit, kryeministrit, Parlamentit dhe liderëve partiak dhe politik. Në Kosovë nuk ka orientim tjetër pos integrimit evropian dhe veriatlantik. Nuk ka orientim tjetër.

Për këtë, nuk është e mjaftueshme vetëm gatishmëria e institucioneve të Kosovës dhe e qytetarëve të Kosovës. Por duhet një përkrahje, në veçanti, nga Evropa dhe jo shtetet në Evropë, jo shtetet individuale, ju lutem; por nga institucionet qendrore, ato të Evropës, sikurse duket që shpeshherë janë në koalizion me mendimet e qeverive vendore dhe ne na jasin një shpresë, një optimizëm vendet individuale të Evropës.

Prandaj, duke dëgjuar debatin e para dy javëve, mendimet e grupeve parlamentare sot, fjalën shum të përgjegjshme të kryeministrit – mendoj që Parlamentit i duhet edhe pak kohë që të marrë vendim në mënyrë që ta ruajë unitetin funksional dhe veprues në institucione.

Nuk jam i gatshëm ta marrë përgjegjësinë që të vë në votim për të shkatërruar diçka që me shum mund e kemi arritur. Por, ndjej përgjegjësi, ndjej përgjegjësi që ne nuk mund ta bllokojmë ardhmërinë e Kosovës me lojëra dhe fjalë që i takojnë të kaluarës; me fajësimë ose ç'fajësimë. Këtë nuk do ta tolerojmë në Parlament dhe le të jetë hera e fundit. Le të jetë hera e fundit! Të debatojmë, të bisedojmë dhe të propozjmë, por ka shum argumente dhe kundërargumente për sjellje të tilla.

Prandaj, ju kërkoj mirëkuptim, në qoftë se ka nevojë edhe ta votojmë, që t'i japim shansë konsensusit aq të nevojshëm politik në Kosovë dhe, mbi të gjitha, konsensusit parlamentar, sepse këtë Parlament e presin detyra shum të rëndësishme dhe i lus partitë politike që do ta humbin takatin deri në vjeshtën e ardhshme sepse shum herët e kanë filluar fazën paralektorale, por në mënyrë institucionale siç jemi të përgjegjshëm këtu.

Prandaj, unë, me lejen tuaj, e nëse doni edhe votojmë, do ta përmbyllja këtë seancë për shkak të tensionimit të brendshëm të secilit nga ne dhe do t'i vazhdojmë ligjet në seancën e ardhshme plenare.

Ju lutem, kush është për këtë propozim? Ju falemnderit.

Kush është kundër? Numëroni votat kundër. Është kryer debati, zoti Meta.

Ju lutem, a ka kush që abstenon? Numëroni votat e abstenimit.

Më lejoni t'ju them se nga 105 deputetë: – 11 vota janë kundër; 5 abstenime.

Prandaj propozimi u miratua, ju falemnderit kryeministër dhe deputetë për pjesëmarje. Vazhdojmë të enjten e ardhshme.

---

**Votimi – Glasanje – Voted:**

- Për – Za – For ..... Shumica – Vecina – Majority
  - Kundër – Protiv – Against ..... 11 .....
  - Abstenime – Uzdrzanih – Abstained... 05 .....
- 

Seanca përfundoi në orën 11,00.

---

E transkriptoi RT (1-22), zyra E-04, Tel.211-860